



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias

KONFERENCA E DYTË E OSBE-SË PËR MEDIAT E EVROPËS JUGLINDORE

DEKLARATË

Përcaktimi i politikave për të ardhmen

Konferenca e dytë e OSBE-së për mediat e Evropës Juglindore, e organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Serbi, dhe me ndihmën e Pranisë së OSBE-së në Shqipëri, Misionit të OSBE-së në Kosovë, Misionin e OSBE-së në Mal të Zi, Misionin e OSBE-së në Bosnjë e Hercegovinë, dhe Misionin e OSBE-së në Shkup, u mbajt më 20-21 shtator 2012 në Beograd të Serbisë.

Rreth 100 ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë, si edhe anëtarë të mediave nga Evropa Juglindore morën pjesë në konferencë për të diskutuar rreth zhvillimeve dhe sfidave të fundit në rajon përkitazi me lirinë e medias.

Konferenca u përqendrua veçanërisht në politikat shtetërore dhe ligjet që e kufizojnë lirinë e medias, ndikimin e interesave afariste në politikat editoriale, si dhe në çështjen e sigurisë dhe vetë-censurën e gazetarëve.

Pjesëmarrësit e konferencës

1. *Njohin rëndësinë e konferencës si një forum rajonal për çështjet dhe sfidat aktuale lidhur me lirinë dhe pluralizmin e medias si përkushtim thelbësor i OSBE-së.*
2. *Mirëpresin faktin se u diskutuan rekomandime konkrete, të cilat do të shërbejnë si një plan për aktivitetet dhe ndihmën pasuese për shtetet pjesëmarrëse.*
3. *Pranojnë që, ndonëse në rajon ka media të lira dhe raportim të pavarur, legjislacioni për mediat, praktikat e dobëta të zbatimit, si dhe interesat afariste dhe politike ende ndikojnë negativisht në lirinë e medias në Evropën Juglindore.*
4. *U bëjnë thirrje qeverive që të përkrahin një sistem të pavarur të transmetuesit publik dhe të sigurojnë kushtet ligjore, politike dhe organizative të nevojshme për funksionimin e mirëfilltë të transmetuesve publikë financiarisht të pavarur dhe të qëndrueshëm.*

5. *Përsërisin* se transmetuesit publikë luajnë një rol kryesor dhe, si rrjedhim, duhet të lejohen që ta mbrojnë pavarësinë e tyre editoriale nga ndërhyrjet politike apo ekonomike.
6. *U bëjnë thirrje qeverive* që të sigurojnë zbatim të duhur të legjislacionit për transmetuesin publik dhe rregullimin e transmetimit nëpërmjet mbikëqyrjes së pavarur nga gjyqësori dhe shqyrtimit të kujdesshëm publik.
7. *U bëjnë thirrje qeverive* që ta harmonizojnë ligjin për shpifje dhe praktikën gjyqësore me standardet e përparuara ndërkombëtare, që do të thotë se rastet e shpifjes duhet të shqyrtohen vetëm nga gjykatat civile dhe administrative, ndërsa kompensimi për dëmin moral duhet të caktohet duke e respektuar parimin e proporcionalitetit, në mënyrë që ata të mos çojnë në falimentim të mediave dhe në një efekt shkurajues për gazetarët.
8. *Shprehin* shqetësim të madh për sulmet kundër medias, duke përfshirë këtu edhe kërcënimet kundër gazetarëve dhe familjeve të tyre, sulmet mbi pronën e medias, dhe sulmet kundër gazetarëve që i mbulojnë ngjarjet publike.
9. *Nxisin* autoritetet që t'i shtojnë përpjekjet për të luftuar dhunën kundër gazetarëve dhe të bëjnë çdo gjë të mundshme për t'i sjellë para drejtësisë ata që janë përgjegjës për sulmet, duke përfshirë këtu intensifikimin e hetimeve të rasteve të vjetra të vrasjeve.
10. *Theksojnë* se pavarësia e politikave editoriale është e domosdoshme për mediat dhe nuk duhet të preket nga ndërhyrjet e shtetit, interesat e korporatave apo ato politike, përfshirë përmes ndihmës shtetërore, reklamimit preferencial dhe praktikave të tjera që mund të përdoren për të ushtruar kontroll mbi mediat.
11. *Njohin* rrezikun serioz të monopolizimit të mediave në Evropën Juglindore nga qarqet politike dhe afariste që i ndjekin agjendat e tyre.
12. *U bëjnë thirrje qeverive* që ta njohin dhe t'i kundërvihen kësaj sfide të lirisë së mediave duke miratuar dhe zbatuar transparencë në legjislacionin mbi pronësinë e mediave dhe ligje të fuqishme antitrust që parandalojnë zvogëlimin e pluralizmit të mediave. Informacionet mbi pronësinë e mediave duhet të vihen në dispozicion të publikut.
13. *U bëjnë thirrje* pronarëve të mediave që të respektojnë pavarësinë editoriale të gazetarëve.
14. *Ftojnë* gazetarët dhe botuesit që të negociojnë dhe lidhin marrëveshje dhe akte nënligjore për pavarësinë editoriale, duke iu referuar marrëveshjeve të tilla në kontratat e punësimit të gazetarëve dhe redaktorëve, për të shmangur autocensurën dhe për ta nxitur raportimin etik të bazuar në standarde profesionale të miratuara vullnetarisht.

15. *Këmbëngulin* për nevojën për kushte të punësimit të formalizuara ligjërisht në përputhje me ligjet nacionale të punës.
16. *Ripohojnë* rëndësinë e së drejtës për qasje në informata si një e drejtë themelore e njeriut dhe u bëjnë thirrje autoriteteve që ta respektojnë këtë të drejtë.
17. *Theksojnë* se përfaqësuesit e mediave duhet të jetë në gjendje që ta ushtrojnë të drejtën e qasjes dhe shpërndarjes në interes të publikut të informatave të mbajtura nga qeveria.
18. *Përsërisin* se përfaqësuesit e mediave nuk duhet të dënohen për marrjen, ruajtjen dhe zbulimin e të dhënave konfidenciale në interes të publikut.
19. *Nxisin qeveritë* që ta lehtësojnë mundësinë e mediave për t'iu qasur informatave të mbajtura nga qeveria, me qëllim të sigurimit të qasjes së opinionit të gjerë në to.
20. *Theksojnë* se për transparencë më të mirë të qeverisë dhe qasje të plotë në informatat e qeverisë, rregullat ekzistuese të klasifikimit në ligjet kombëtare duhet të jenë të kufizuara në fushë të zbatimit dhe në kohë. Vetëm ato të dhëna publikimi i të cilave do të mund të rrezikonte seriozisht sigurinë kombëtare duhet të jenë të klasifikuara.
21. *Vënë në dukje* se raportimi investigativ në interes të shoqërisë është i mundur vetëm nëse burimet konfidenciale të gazetarëve mund të mbështeten në moszbulimin e identitetit të tyre dhe, kështu, nxisin qeveritë që të vendosin dispozita ligjore të mjaftueshme në përputhje me standardet ndërkombëtare ekzistuese që garantojnë të drejtën e gazetarëve për të mos i zbuluar burimet e tyre konfidenciale.
22. *Pranojnë* se në epokën digjitale çështja e licencimit të transmetuesve tokësor mbetet prioritet i lartë e qeverisë dhe duhet të shërbejë si nxitës i pluralizmit dhe diversitetit. Procesi i digjitalizimit nuk duhet që në asnjë rast të përdoret për ta kufizuar mundësinë e transmetuesve ekzistues që ta vazhdojnë punën e tyre pas kalimit në transmetimin digjital.
23. *U bëjnë thirrje qeverive* që ta mbështesin dhe përshpejtojnë procesin e digjitalizimit të transmetuesve publikë, për të siguruar që ata e përmbushin përgjegjësinë e tyre të transmetimit publik, duke kontribuar kështu në forcimin e debatit dhe vlerave demokratike.

Beograd, 21 shtator 2012